

## **DEKLARATA PËR PRIVATËSI GJATË REALIZIMIT TË MBIKËQYRJES VIDEO**

Me këtë Deklaratë për Privatësi shpjegohet lloji i të dhënave personale që, Shoqëria për Tregti dhe Shërbime MTEL DOOEL Shkup (MTEL SHPKNJ), në cilësinë e Kontrolluesit të të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejshëm: Kontrolluesi ose MTEL DOOEL Shkup), i mbledh nëpërmjet sistemit të video mbikëqyrjes të vendosur në sallonin e shitjes.

Gjithashtu, Deklarata shpjegon në detaje se si MTEL DOOEL SHKUP i përdor këto të dhëna.

### **1. Pse i mbledhim (përpunojmë) të dhënat tuaja personale?**

MTEL DOOEL SHKUP i mbledh të dhënat tuaja personale nëpërmjet sistemit të mbikëqyrjes video të instaluar në sallonin e shitjes, për të siguruar mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve në sallonin e shitjes ku vendoset mbikëqyrja video për shkak të natyrës së punës së tyre, duke ofruar kontroll mbi hyrje-daljen nga salloni i shitjes vetëm për qëllime sigurie, si dhe mbrojtje të pasurisë ose pronës së sallonit të shitjes ku është instaluar mbikëqyrja video (vjedhja dhe dëmtimi aparateve i dhe pajisjeve, vjedhja e parave dhe pasurive të tjera).

Sistemi i mbikëqyrjes video nuk përdoret për asnjë qëllim tjetër përveç sa më sipër.

Video kamerat janë të pozicionuara në mënyrë që të ofrojnë vetëm incizime vizuale të personave fizik (fytyra dhe pamja fizike e personave, përfshirë edhe të miturit) të cilët e vizitojnë sallonin e shitjes së MTEL DOOEL Shkup.

Kamerat për video mbikëqyrje vendosen dhe fokusohen ashtu që të regjistrojnë hyrjen dhe daljen nga salloni i shitjes së MTEL DOOEL Shkup, pastaj i regjistrojnë sportelet ku bëhet pagesa dhe ku lëshohen aparatet dhe pajisjet, raftet me aparaturat, si dhe prona të tjera që duhet të mbrohen, me ç'rast regjistrohen punonjësit, klientët dhe vizitorët e tjerë kur të hyjnë në fokusin e tyre.

Sistemi i mbikëqyrjes video nuk përdoret si mjet hetimor apo për të fituar prova për hetime të brendshme në MTEL DOOEL SHKUP, përveç nëse ka ndonjë incident sigurie që lidhet me qëllimin për të cilin krijuar mbikëqyrja video është vendosur në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. (Në rrethana të jashtëzakonshme, të dhënat mund t'u transferohen autoriteteve kompetente në kuadër të ndonjë procedure penale formale).

### **2. Çfarë të dhënash mbledhim?**

Nëpërmjet sistemit të vëzhgimit me video, MTEL DOOEL SHKUP mbledh vetëm imazhe vizuale të individëve (fytyra dhe pamja fizike e punonjësve, klientëve dhe vizitorëve të tjerë në dyqan). Gjatë kësaj nuk bëhet regjistrim audio.

### **3. Kush është përgjegjës për përpunimin e të dhënave?**

MTEL DOOEL SHKUP e kryen përpunimin e të dhënave personale dhe i përcakton qëllimet e përpunimit, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Goran Mandiq është person kontaktues dhe personi përgjegjës për kryerjen e mbikëqyrjes video.

#### **4. Cila është baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit për mbikëqyrje video?**

MTEL DOOEL SHKUP përdor pajisje për mbikëqyrje video për të siguruar:

- mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve në sallonin e shitjes ku vendoset mbikëqyrja video për shkak të natyrës së punës tyre,
- kontrollin e hyrjes dhe daljes nga salloni i shitjes për qëllime sigurie dhe
- mbrojtjen e pronës.

Prandaj, përpunimi është i ligjshëm në përputhje me nenin 90 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Gjithashtu, në hyrje të sallonit të shitjes është vendosur një njoftim në vend të dukshëm dhe qartë për mbikëqyrjen video që u mundëson punonjësve, klientëve dhe vizitorëve të tjerë të njihen për realizimin e mbikëqyrjes me video, si dhe emrin e Kontrolluesit i cili e realizon mbikëqyrjen video dhe për mënyrën si mund të merret informacion se ku dhe për sa kohë ruhen regjistrimet e sistemi për mbikëqyrje me video.

#### **5. Kush mund të shohë të dhënat e mia personale?**

Qasje në video regjistrimet mund të kenë vetëm personat autoritetet e vëzhgimit me video.

Qasja te në video regjistruesin digjital NVR në të cilin ruhen video regjistrimet është e kufizuar në administratorin e sistemit të mbikëqyrjes video, i cili është i autorizuar nga menaxheri i MTEL DOOEL SHKUP.

Vetëm personat e autorizuar nga menaxheri i MTEL DOOEL SHKUP kanë qasje dhe këqyrje në të dhënat personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të mbikëqyrjes video.

Qasja mbrohet me aplikimin e masave teknike të sigurisë së të dhënave (fjalëkalimi, regjistrimi i çdo ngjarjeje ose veprimi nga personat e autorizuar)

#### **6. Si t'i kontrolloj të dhënat e mia?**

Nëse keni pyetje në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale nëpërmjet sistemit të mbikëqyrjes video, mund të dërgoni një kërkesë në MTEL DOOEL Shkup në adresën e e-mailit: [office@mtel.mk](mailto:office@mtel.mk) ose në [adresën rr. "Maksim Gorki" nr.11-1 / 3, 1000 Shkup](#) ose [parashtroni kërkesën në sallonin e shitjes së MTEL DOOEL Shkup.](#)

#### **7. A mund të kem qasje deri te të dhënat e mia?**

Ju keni të drejtë të kërkonti konfirmim nëse të dhënat tuaja personale përpunohen, si dhe të keni qasje te të dhënat tuaja në çdo kohë dhe pa pagesë, duke dërguar një kërkesë në MTEL DOOEL SHKUP në e-mail adresën e mëposhtme të: [office@mtel.mk](mailto:office@mtel.mk) ose në adresën: [rr. "Maksim Gorki" Nr 11-1 / 3, 1000 Shkup](#) ose duke paraqitur një kërkesë në sallonin e shitjes. Formularin e aplikimit mund të shkarkoni në linkun e mëposhtëm: [www.mtel.mk](http://www.mtel.mk).

#### **8. A mund t'i ndryshoj të dhënat e mia?**

Nuk lejohet modifikimi i videos nga mbikëqyrja video i realizuar.

### **9. A mund të kërkoj një kufizim në përpunimin e të dhënave të mia?**

Ju keni të drejtë të kufizoni përpunimin e të dhënave tuaja personale në çdo kohë duke dërguar një kërkesë në MTEL DOOEL SHKUP në e-mail adresën e mëposhtme: [office@mtel.mk](mailto:office@mtel.mk) ose në adresën: [rr. "Maksim Gorki" nr.11-1 / 3, 1000 Shkup ose me](http://rr. ) paraqitjen e një kërkesë në sallonin e shitjes, në rast se e kundërshtoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, ose kur ne nuk kemi më nevojë për të dhënat për të arritur qëllimet e përpunimit. Ju gjithashtu mund të kufizoni përpunimin kur përpunimi është i paligjshëm, ndërsa Ju we kundërshtoni fshirjen e të dhënave personale.

Megjithatë, kufizimi i përpunimit të të dhënave tuaja personale nuk është i mundur në rastin e një hetimi zyrtar.

### **10. A mund të kërkoj fshirjen e të dhënave të mia?**

Ju keni të drejtë të kërkonit fshirjen e të dhënave tuaja në çdo kohë duke dërguar një kërkesë në MTEL DOOEL SHKUP në e-mail adresën e mëposhtme : [office@mtel.mk](mailto:office@mtel.mk) ose në: [rr. "Maksim Gorki "Nr.11-1 / 3, 1000 Shkup ose](http://rr. ) duke paraqitur një kërkesë në sallonin e shitjes, në rast se të dhënat personale janë përpunuar në mënyrë të paligjshme ose nuk janë më të nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur.

### **11. A ndahet të dhënat e mia personal me palët e treta?**

Të dhënat tua personale i ruajmë dhe nuk i ndajmë me presona të tjerët, përveç nëse Ju kërkonit ose pranoni që të ndahen.

Në rast se të dhënat tuaja ndahen me palët e treta, ju do të njoftoheni se kujt i janë zbuluar ato, për çfarë qëllimi dhe mbi çfarë baze ligjore.

### **12. A kam të drejtë të kundërshtoj?**

Po, ju keni të drejtë të kundërviheni dhe të kundërshtoni përpunimin në çdo kohë duke dërguar një kërkesë në MTEL DOOEL SHKUP në e-mail adresën e mëposhtme: [office@mtel.mk](mailto:office@mtel.mk) ose në adresën: [rr. Maksim Gorki nr.11-1 / 3, 1000 Shkup ose](http://rr. Maksim Gorki nr.11-1 / 3, 1000 Shkup ose) duke paraqitur një kërkesë në sallonin e shitjes, kur keni arsye legjitime në lidhje me situatën tuaj konkrete.

### **13. Çfarë mund të bëj në rast të ndonjë problemi?**

a) Hapi i parë është të na njoftoni për problemin me email: [office@mtel.mk](mailto:office@mtel.mk) ose [në adresën: rr. Maksim Gorki nr.11-1 / 3, 1000 Shkup ose](http://rr. Maksim Gorki nr.11-1 / 3, 1000 Shkup ose) në sallonin e shitjes dhe kërkonit që të ndërmerret veprim konkret.

b) Hapi i dytë, nëse nuk merrni përgjigje nga ne ose nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjen, kontaktoni oficeren tonë për mbrojtjen e të dhënave personale: Mariana Marushiq Kos në e-mail: [marijana@marusic-kos.mk](mailto:marijana@marusic-kos.mk).

Në çdo kohë mund paraqitni kërkesë në Agjencinë për Mbrojtje të të Dhënave Personale [www.azlp.mk](http://www.azlp.mk), e cila do të veprojë sipas kërkesës tuaj dhe do t'i ndërmerr masat e nevojshme.

#### **14. Kur do të fillojë përpunimi i të dhënave të mia personale nëpërmjet sistemit të mbikëqyrjes video?**

Përpunimi fillon në momentin kur hyni në fokus, pra në fushën e shikimit të kamerave që vendosen në sallonin e shitjes së MTEL DOOEL SHKUP dhe zgjat deri në daljen nga fokusi, pra nga fusha e shikimit të kamerave.

#### **15. Siguria e të dhënave personale**

Ne jemi të përkushtuar të mbrojmë të dhënat e Juaja personale. Prandaj, sigurojmë masa të duhura të sigurisë teknike dhe organizative për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit të mbikëqyrjes video, me të cilat garantohet mbrojtja e konfidencialitetit, integritetit dhe dispozicioni i të dhënave të Juaja personale. Ne i mbrojmë të dhënat e Juaja personale nga qasja e paautorizuar dhe përdorimi ose zbulimi i paautorizuar i të dhënave.

#### **16. Sa kohë i ruajmë të dhënat tuaja?**

Regjistrimet nga mbikëqyrja video, gjegjësisht të dhënat e Juaja ruhen deri në përmbushjen e qëllimit për të cilin realizohet mbikëqyrje me video, por jo më gjatë se 30 ditë, që fillon të llogaritet nga dita kur është bërë regjistrimi individual. Pas periudhës 30-ditore, pamjet e mbikëqyrjes video fshihen automatikisht.